KËSHILLI I EUROPËS

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA BESHIRI ETJ. KUNDËR SHQIPËRISË
(ANKIMI NR. 7352/03)

VENDIM
STRASBURG
22 GUSHT 2006

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Beshiri etj. kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), me trup gjykues të përbërë prej:

sir. NICOLAS BRATZA*, President*
z. J. CASADEVALL
z. G. BONELLO
z. K. TRAJA
z. S. PAVLOVSCHI
z. L. GARLICKI
znj. L. MIJOVIC, gjykatës
dhe z. T.L. EARLY, regjistrues i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura në datën 11 korrik 2006, merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja ka filluar në bazë të ankimit (Nr. 7352/03) kundër Republikës së Shqipërisë drejtuar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga katër vëllezër e motra, të gjithë shtetas shqiptarë, z. Njazi Beshiri, znj. Liri Kaba, znj. Xhilda Koka dhe z. Sair Preza ("ankuesit") më 16 shkurt 2003.

2. Ankuesit u përfaqësuan nga z. A. Tartari, avokat që e ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Pala shqiptare u përfaqësua nga agjenti i saj, z. S. Puto, nga Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Më 3 maj 2005, Gjykata vendosi t'ia komunikonte ankimin palës shqiptare. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi të shqyrtonte themelin e ankimit, si dhe njëkohësisht pranueshmërinë e tij.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

4. Ankuesit kanë lindur përkatësisht në vitin 1931, 1948, 1954 dhe 1944 dhe jetojnë në Tiranë (Shqipëri) dhe Varese (Itali).

5. I ati i ankuesve ka qenë pronar i një vile me një sipërfaqe prej 42.70 metra katrorë dhe dy parcelash toke afër saj, të matura përkatësisht me afro 46.70 metra katrorë dhe 48.55 metra katrorë. Nga viti 1946 deri në 1978, i ati i ankuesve ia dha me qira vilën të atit të B.N.-së.

6. Në një datë të paspecifikuar, pasi vila ishte e pabanueshme, shteti i dha të atit të kërkuesve një hua të detyrueshme prej 16,204 lekë (Total) për ristrukturimin e vilës.

7. Në vitin 1976, B.N. ndërtoi dy ndërtesa shtesë në parcelën e tokës me matje prej 48.55 metra katrorë. Me anë të një vendimi të datës 23 shkurt 1976, Gjykata e Rrethit, Tiranë, ia alokoi ndërtesat shtesë B.N.-së.

8. Si rezultat i pamundësisë së të atit të ankuesve për të shlyer borxhin, vila u shtetëzua në bazë të vendimit nr.133 të datës 14 korrik 1978. Nga viti 1978 e në vazhdim, familja e B.N.-së vazhdoi të jetonte në vilë si banues në një pronë shtetërore.

A. Procedurat në lidhje me kthimin e pronës

9. Në vitin 1996, sipas ligjit të kthimit dhe kompensimit të pronave (“Ligji i Pronësisë”), ankuesit paraqitën një ankesë pranë Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

10. Më 22 maj 1996, Komisioni i Tiranës duke argumentuar se shtetëzimi i vilës së të atit të ankuesve ishte i paligjshëm, u ktheu atyre vilën (një zonë me sipërfaqe prej 42.70 metra katrorë) dhe parcelën e tokës të matur prej 46.70 metra katrorë, subjekt i shlyerjes së totalit prej 1,204 (që përfaqëson sasinë e papaguar të borxhit të të atit të tyre ndaj shtetit, gjë që kishte çuar në shtetëzimin e pronave). Për sa i përket parcelës së tokës prej 48.55 metra katrorë, në lidhje me investimin e B.N.-së në ndërtesën shtesë, Komisioni mbështeti të drejtën e refuzimit të parë mbi blerjen e tokës.

B. Procedimet gjyqësore

11. Në një datë të paspecifikuar në vitin 1997, B.N., banori i vilës që u ishte alokuar ankuesve, ngriti një padi civile në Gjykatën e Tiranës, duke pretenduar të drejta pronësie mbi vilën dhe parcelën e tokës afër saj. Për më tepër ai pretendoi, se vendimi i Komisionit i datës 22 maj 1996 duhet të deklarohej i pavlefshëm, për sa kohë që ka qenë në shkelje të nenit 13 të Ligjit të Pronësisë.

12. Më 15 korrik 1997, Gjykata e Tiranës e deklaroi vendimin e Komisionit të datës 22 maj 1996 të pavlefshëm. Ajo konkludoi se, sipas raportit të ekspertit, shpenzimet nga shteti dhe i ati i B.N.-së mbi ndryshimet strukturore dhe shtojcat e ndërtesës fillestare arrinin më tepër, sesa 85 % të vlerës fillestare të pronës. Kështu, vendimi i Komisionit ishte në shkelje të nenit 13 të Ligjit të Pronësisë.

13. Më 7 nëntor 1997, Gjykata e Apelit e Tiranës, pasi shqyrtoi apelin e ankuesve, të cilët pretendonin shkelje të së drejtës së pronës, mbështeti vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe rrëzoi apelin.

14. Ankuesit u ankuan në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, i cili më 6 maj 1998 anuloi vendimet e gjykatave të sipërcituara. Kolegji gjykoi se vendimet ishin bazuar mbi raportin e ekspertëve, që nuk ishte logjik dhe përmbante llogaritje të pasakta dhe kështu, e ktheu çështjen për rigjykim.

15. Më 11 prill 2001, Gjykata e Apelit e Tiranës, pasi rigjykoi çështjen, deklaroi vendimin e Komisionit të pavlefshëm. Duke u mbështetur në një raport të ri ekspertësh, ajo konkludoi se shtetëzimi i vilës së të atit të kërkuesve kishte qenë në përputhje me kërkesat e ligjit material në kohën fizike dhe për pasojë, ankuesit nuk mund të përfitonin nga procesi i kthimit të pronave. Për më tepër, gjykata mbështeti të drejtat e pronësisë së ankuesve mbi dy parcelat e tokës afër saj dhe sipas nenit 16 të Ligjit të Pronësisë, vendosi mbi të drejtën e tyre për të marrë kompensim në një prej formave të parashikuara me ligj.

16. Më 15 shkurt 2002, vendimi civil i Gjykatës së Lartë rrëzoi apelin nga ankuesit, si të pabazuar.

C. Procedimet në Gjykatën Kushtetuese

17. Ankuesit paraqitën rekurs pranë Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131(f) të Kushtetutës. Ata pretenduan se vendimi i Gjykatës së Lartë dhe vendimi i Gjykatës së Apelit ishin jokushtetues.

18. Më 24 shtator 2002, Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 31 të Ligjit të Organizimit dhe Funksionimit të Gjykatës Kushtetuese (Ligji nr. 8577 i datës 10 shkurt 2000), vendosi të deklarojë *de plano* të papranueshëm rekursin, pasi ishte “jashtë juridiksionit”.

D. Kompensimi

19. Nëpërmjet një letre të datës 22 mars 2004, ankuesit informuan Zyrën e Regjistrit se autoritetet nuk pajtoheshin me vendimin e formës së prerë të datës 11 prill 2001 në lidhje me çështjen e kompensimit.

LEGJISLACIONI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

20. Nga Kushtetuta e Shqipërisë citohet si më poshtë:

Neni 41

“1. E drejta e pronës private është e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë”.

Neni 42§2

“ Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 142 § 3

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për:...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave”.

Neni 181

“1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.”

B. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave (Ligji nr.7698 i datës 15 prill 1993, amenduar me ligjin nr.8084 të vitit 1996 dhe shfuqizuar me ligjin nr.9235 të datës 29 korrik 2004)

21. Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës pësoi disa amendime gjatë dhjetë viteve të shkuara.

22. Ligji i Pronësisë i vitit 1993 (Ligji nr. 7698 i datës 15 prill 1993, amenduar nga ligji nr. 8084 i vitit 1996), në fuqi atë kohë, në pjesën e tij përkatëse citon:

Neni 4(1)

"U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen ose kompensohen në natyrë ish - pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre ligjorë, pronat në formën e kullotës, livadhit, tokës pyjore, apo tokës bujqësore dhe jobujqësore të patrajtuar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", që janë në pronësi të shtetit, kur këto prona do të tjetërsohen në truall duke u përfshirë brenda sipërfaqes së vijave të reja kufizuese ndërtimore të qendrave të banuara. Masa e kthimit ose e kompensimit në natyrë bëhet e plotë, por në të gjitha rastet jo më shumë se 10 000 m^2, sipas përcaktimit të bërë në paragrafin e katërt të nenit 1 të dekretit nr. 1359 të datës 5 shkurt 1996, amenduar me ligjin nr. 8084 të datës 7 mars 1996.”

Neni 13

Kur në objektin ish-pronë private janë kryer nga shteti apo pronari shpenzime për ndryshime në strukturë, shtesa anësore apo shtesa kati etj., objekti i kthehet ish-pronarit pa kundërshpërblim, kur vlefta e shpenzimeve përbën deri 20 për qind të vlerës së objektit.

Kur në objektin ish-pronë private vlefta e shpenzimeve të kryera përbën 20 deri në 50 për qind të vleftës së objektit, ai mund të kalojë në pronësi të ish-pronarit, pasi të jetë shlyer

nga ana e tij kundërvlefta e mësipërme, mbi 20 për qind, e llogaritur në bazë të çmimeve të ndërtimit në kohën e rikthimit të pronës. Kur vlera e shpenzimeve të kryera është mbi 50 për qind e vlerës së objektit, objekti mbetet në bashkëpronësi... Mosmarrëveshjet midis palëve zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Neni 16

Kur trojet janë zënë me ndërtime të përhershme, pronarët kompensohen me kufijtë e shpronësimit, me mënyrat e mëposhtme:

a) me obligacione shtetërore, që do të përdoren sipas vlerës ekuivalente dhe me përparësi në marrëdhënie me shtetin si në procesin e privatizimit të objekteve shtetërore e në veprimtari të tjera që kryhen me kredi.

b) me sipërfaqe trojesh ekuivalente pranë qendrave të banuara në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme, por jo më shumë se 5000 m^2;

c) me sipërfaqe ekuivalente në zonat turistike, në përputhje me planet rregulluese të përgjithshme, por jo më shumë se 5000 m^2.

Pjesa tjetër, për pikat b dhe c do të kompensohet sipas mënyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj.

Këshilli i Ministrave përcakton rregulla më të hollësishme për mënyrat dhe afatet e kryerjes së këtyre kompensimeve.

23. Ligji i ri i Pronave, i dekretuar në vitin 2004, parashikon dy forma të kthimit të pronës, më konkretisht, kthimin në natyrë të pronës, nëse plotësohen disa kushte dhe kompensimin, në rast të pamundësisë nga ana e autoriteteve për të kthyer në natyrë pronën. Ligji parashikon pesë forma kompensimi: a) me një pronë të të njëjtit lloj; b) me një pronë të një lloji tjetër; c) me aksione në kompanitë shtetërore; d) me vlerën e një prone shtetërore në proces privatizimi; e) me një shumë parash (neni 11).

24. Ligji krijoi Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, të përbërë prej pesë anëtarësh të zgjedhur nga Parlamenti. Roli i tij është të vendosë mbi ligjshmërinë e vendimeve të komisioneve lokale. Në nivel lokal, vendimet mbi pretendimet e kthimit dhe kompensimit të pronave duhet të merren nga Komisionet Lokale për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (neni 15).

25. Në pajtim me ligjin, personat e autorizuar për të kërkuar kthim ose kompensim, duhet të bëjnë një kërkesë për këtë qëllim pranë komisioneve lokale deri më 31 dhjetor 2007 (neni 19). Ligji i jep komitetit diskrecionin për të vendosur se cila prej formave të kompensimit duhet të jepet. Personat e autorizuar duhet të shprehin preferencat e tyre me shkrim në lidhje me formën e kompensimit që duhet të jepet. Vendimi i komisioneve lokale mund të apelohet në Komitetin Shtetëror (neni 11).

26. Me qëllim pajtueshmërinë me vendimet e komisioneve që japin pagesë për kompensim financiar, neni 23 i ligjit të sipërpërmendur, parashikon krijimin e një fondi kompensimi dhjetëvjeçar të pronës, qëllimi i të cilit është sigurimi i ndihmës financiare për këto vendime.

27. Ligji i sipërpërmendur u shqyrtua nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë.

28. Më 24 mars 2005, Gjykata e Lartë, Kolegjet e Bashkuara, konstatoi se Ligji i Pronësisë i vitit 2004 nuk kishte efekt prapaveprues dhe se në këtë mënyrë dispozitat e tij nuk mund të kishin ndikim mbi të drejtat e pronësisë, të njohura nga vendimet administrative ose të gjykatës, të dhëna para hyrjes së tij në fuqi.

29. Në nëntor 2005, Qeveria (e zgjedhur kohët e fundit më 3 korrik 2005) paraqiti në Parlament një projektligj të ri mbi ligjin e kthimit dhe kompensimit të pronave, i cili propozon disa amendime të Ligjit të Pronësisë të vitit 2004. Projektligji, i cili aktualisht është pezulluar pranë Parlamentit, do të diskutohet në muajt e ardhshëm.

I. KUNDËRSHTIMI PARAPRAK I PALËS SHQIPTARE

30. Pala shqiptare arsyetoi se ankimi ishte i papranueshëm, pasi ishte bërë jashtë afatit gjashtëmujor të parashikuar në nenin 35§1 të Konventës. Kështu, për shkak të karakterit diskrecionar të procedimeve në Gjykatën Kushtetuese dhe vendimit të papranueshmërisë *de plano* të kësaj të fundit në çështjen aktuale, rregullimi përfundimtar efektiv brenda kuptimit të kësaj dispozite ishte në fakt vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 15 shkurt 2002, ndërsa ankuesit kishin bërë një kërkesë më 16 shkurt 2003.

31. Si përgjigje, duke iu referuar nenit 131 (f) të Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, ankuesit u shprehën se me qëllim shterimin e të gjitha mjeteve juridike të brendshme, individët duhet të paraqisnin një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese, nëse pretendonin një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë. Për më tepër, ankesa në lidhje me moslegjitimimin e pretenduesit në procedimin përkatës lidhej me konceptin e një seance të ndershme, përcaktuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Kjo e fundit kishte juridiksionin dhe detyrimin për të shqyrtuar çështjen dhe për të vendosur mbi të, nëse mund të ishte e nevojshme me anë të një vendimi. Kështu, ankuesit pretenduan se ata kishin paraqitur kërkesën pranë Gjykatës në kohë (vendimi i Gjykatës Kushtetuese ishte i datës 24 shtator 2002, edhe pse ishte një vendim papranueshmërie *de plano)*.

32. Gjykata nënvizoi përfundimet e saj në vendimin Balliu v Albania (Nr. 74727/01 të datës 30 shtator 2004), ku kishte konkluduar se një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese Shqiptare mund të konsiderohej një mjet juridik efektiv që duhet të përdorej për qëllime të nenit 35 të Konventës, sa herë ngriheshin çështje të procesit të rregullt. Ajo çmoi se nuk ka arsye për të devijuar nga ky konkluzion në rrethanat e kësaj çështjeje.

33. Ankuesit në fakt përdorën këtë mjet juridik. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i datës 24 shtator 2002 dhe kërkuesit paraqitën kërkesën e tyre më 15 shkurt 2002. Në këtë mënyrë, ata ishin në pajtim me afatin gjashtëmujor, të parashikuar në nenin 35.

34. Për këto arsye, Gjykata hedh poshtë kundërshtimin e palës shqiptare.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 DHE NENIT 13 TË KONVENTËS

35. Ankuesit u ankuan për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në disa aspekte. Gjithashtu, ata argumentuan se nuk kishin asnjë mjet juridik të brendshëm në lidhje me shkeljet e prentenduara (neni 13 i Konventës).

Neni 6 § 1, për sa kohë që është i zbatueshëm, vijon si më poshtë:

“Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile…, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë”.

Neni 13 parashikon:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

A. Pranueshmëria

1. Lidhur me rregullsinë e procedimeve

36. Ankuesit u ankuan sipas nenit 6§1 të Konventës për proces të parregullt, duke arsyetuar se B.N. nuk duhej legjitimuar në procedimet e brendshme për të kundërshtuar të drejtat e tyre të pronësisë.

37. Gjykata thekson se nuk është detyra e saj për të zënë vendin e gjykatave kombëtare. Është kryesisht detyra e autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit të brendshëm (shih Edificaciones March Gallego S.A. v Spain, vendimi i datës 19 shkurt 1998, Reports of Judgments and Decisions 1998-I, fq 290, § 33). Roli i Gjykatës kufizohet në vërtetimin nëse procesi i gjykimit në tërësi ishte i rregullt (shih, mutadis mutandis, Edwards v the United Kingdom, vendimi i datës 16 dhjetor 1992, Seria A nr. 247-B, fq 34-35, § 34 dhe Garcia Ruiz v Spain [GC], No 30544/96, § 28, ECHR 1999-I).

38. Duke u kthyer te çështja në fjalë, Gjykata çmon se procedimet para gjykatave vendase ishin tërësisht në pajtim me kërkesat e nenit 6§1 të Konventës, pasi lejuan ankuesit të përdornin efektivisht të gjitha të drejtat e tyre procedurale. Gjykatat kombëtare shqyrtuan me kujdes pretendimet e kthimit dhe dhanë vendime të arsyetuara, duke adresuar argumentet e paraqitura nga ankuesit. Gjykata nuk konstaton shenja të ndonjë shkeljeje të nenit 6§1 të Konventës, sipas këtij kreu.

39. Për rrjedhojë, ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet hedhur poshtë në përputhje me nenin 35 § § 3 dhe 4 të Konventës.

40. Për sa i përket parashtrimit të ankuesve, që ata nuk kishin mjete ligjore efektive në dispozicion në lidhje me ankimin e mësipërm, Gjykata thekson se neni 13 zbatohet vetëm kur një individ ka një “pretendim të pranueshëm” se ka qenë viktimë e cenimit të një të drejte, sipas

Konventës (shih Boyle and Rice v. the United Kingdom, vendimi i datës 27 prill 1988, Seria A nr. 131, fq 23§ 52). Gjykata konkludoi më sipër, se ankimi sipas nenit 6§1 është haptazi i pabazuar. Ankuesit nuk kanë një pretendim të pranueshëm, ndaj për këtë arsye neni 13 nuk është i zbatueshëm për çështjen.

41. Për rrjedhojë, kjo pjesë e ankimit është haptazi e pabazuar dhe duhet rrëzuar në përputhje me nenin 35 § § 3 dhe 4 të Konventës.

2. Për sa i përket kohëzgjatjes së procedimeve

42. Gjithashtu ankuesit pretenduan për shkelje të nenit 6 § 1, duke pohuar, se pesë vjet për të vendosur në lidhje me pretendimet e pronësisë së tyre nuk mund të konsideroheshin periudhë e arsyeshme e kohëzgjatjes së procedimeve.

43. Gjykata pohon se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet në bazë të disa rrethanave specifike të çështjes, si dhe duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara në jurisprudencësn e Gjykatës, veçanërisht kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e ankuesve dhe autoriteteve përkatëse (shih, midis shumë autoritetesh të tjera , Frydlender v. France [GC], nr. 30979/96, § 43, ECHR 2000-VII).

44. Gjykata përsëriti se periudha që duhet marrë në konsideratë ka filluar në një datë të papërcaktuar në vitin 1997, kur B.N. filloi procedime në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe përfunduan më 24 shtator 2002, kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese u depozitua në regjistrin e Gjykatës Europiane. Kështu, procesi zgjati rreth pesë vjet dhe tetë muaj në total për gjashtë nivele juridiksioni. Ajo çmoi se çështja në fjalë kishte të bënte me një situatë faktike mjaft komplekse, ku gjykatat duhej të përcaktonin të drejtat e pronësisë së kërkuesve, mbi bazën e raporteve komplekse të ekspertëve.

45. Në disa rrethana, periudha totale në çdo nivel juridiksioni nuk mund të konsiderohej e tejzgjatur në mënyrë të pajustifikuar. Për më tepër, ankuesit nuk arritën të demonstronin se kishte pasur ndonjë periudhë pasiviteti të konsiderueshëm për faj të autoriteteve gjyqësore gjatë zhvillimit të procesit.

46. Për rrjedhojë, kjo pjesë e kërkesës është haptazi e pabazuar dhe duhet rrëzuar në përputhje me nenin 35 § § 3 dhe 4 të Konventës.

47. Përsa pretendimet e ankuesve, sipas nenit 13 mund të kuptohen si ankim për mungesë të mjeteve efektive juridike në lidhje me kohëzgjatjen e procesit civil, ku ata janë palë; për të njëjtat arsye të dhëna në paragrafin 40 më sipër, Gjykata konstaton se neni 13 nuk është i zbatueshëm.

48. Për rrjedhojë, kjo ankesë është haptazi e pabazuar dhe duhet rrëzuar në përputhje me nenin 35 § § 3 dhe 4 të Konventës.

3. *Në lidhje me neglizhencën e pretenduar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor*

49. Sipas nenit 6 § 1 dhe 13 të Konventës, ankuesit u ankuan rreth neglizhencës së autoriteteve për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë të datës 11 prill 2001, në lidhje me çështjen e kompensimit.

50. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë argument. Ajo i qëndroi mendimit se kërkuesit nuk e pranonin rezultatin e procedimeve që çuan në vendimin e datës 11 prill 2001. Në këto kushte, ata neglizhuan të kërkonin fillimin e procesit të ekzekutimit në Gjykatën e Rrethit, Tiranë, ku do të siguronin daljen e urdhrit me shkrim për zbatimin e vendimit në fjalë. Për më tepër, referuar vëzhgimeve të palës shqiptare, ankuesit gjithashtu nuk kishin përdorur mjetet juridike të parashikuara në Ligjin e ri të Pronësisë (Ligji nr. 9235 i datës 29 korrik 2004) sa i takon kompensimit. Kështu, pretendimi i ankuesve sipas këtij kreu duhej të deklarohej i papranueshëm për neglizhencë të përdorimit të mjeteve juridike të brendshme.

51. Ankuesit kundërshtuan efektivitetin e mjeteve juridike të referuara nga pala shqiptare. Ata argumentuan se Ligji i ri i Pronësisë nuk siguronte mjete juridike në kuptimin e Konventës. Ata vërejtën më tej se të drejtat e tyre të pronësisë ishin përcaktuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe se një organ administrativ nuk mund të rishqyrtonte të njëjtën çështje. Së fundi, ata pohuan se nëse gjykatat vendase do të kishin urdhëruar kompensim në një nga format e parashikuara nga ligji, përmbaruesit nuk do të kishin qenë në gjendje ta ekzekutonin atë vendim. Varet nga autoritetet shtetërore implementimi i masave efektive, qoftë nëpërmjet klasifikimit të pronave shtetërore që do të përdoren për kompensim në natyrë, qoftë duke siguruar

fonde të mjaftueshme buxhetore për kompensim financiar, me qëllim që kjo mënyrë ndreqjeje të realizohet. Në përfundim, ankuesit i qëndruan mendimit se pala shtetërore deri tani kishte neglizhuar marrjen e hapave efektivë për të gjetur zgjidhje në lidhje me çështjen e kompensimit.

52. Gjykata theksoi se rregulli i shterimit të mjeteve juridike të brendshme, referuar nenit 35 § 1 të Konventës, detyron ankuesit të shterojnë mjetet juridike që në sistemin ligjor vendas janë normalisht në dispozicion dhe të mjaftueshme për t'i mundësuar ata të sigurojnë rivendosjen e së drejtës që pretendohet se është shkelur. Mjetet juridike duhet të jenë mjaftueshmërisht të besueshme, si në praktikë dhe në teori. Pa këtë garanci, të cilën është përgjegjësi e shtetit ta sigurojë, këto mjete nuk do të mund të shterohen sipas nevojave dhe do të mbeten jo efektive (shih Vernillo v. France, vendim i datës 20 shkurt 1991, Seria A, nr. 198, fq 11-12, § 27; Aksoy v. Turkey, nr. 21987/93, §§ 51-52, Reports 1996-VI; dhe Akdivar and Others v. Turkey, No 21893/93, §§ 65-67, Reports 1996-IV).

53. Gjykata vlerëson se mjetet juridike të referuara nga pala shqiptare, ishin të pamjaftueshme për vënien në vend të shkeljes së pretenduar.

54. Në veçanti, për sa i përket argumentit të autoriteteve shtetërore në lidhje me neglizhencën e ankuesve për të filluar procedimet e ekzekutimit, Gjykata rithekson se një personi, i cili pajiset me një vendim të ekzekutueshëm kundër shtetit në favorin e tij, nuk mund t'i kërkohet t'u drejtohet organeve përmbarimore për të ekzekutuar vendimin (shih Cocchiarella v. Italy {GC}, nr. 64886/01, § 89, ECHR 2006; Metaxas v. Greece, nr. 8415/02, § 19, 27 maj 2004; Koltsov v. Russia, No 41304/02, § 16, 24 shkurt 2005; dhe Petrushko v. Russia, No 36494/02, § 18, 24 shkurt 2005).

55. Për më tej, për sa i përket kundërshtimit në lidhje me neglizhencën e ankuesve për të përdorur mjetet juridike të parashikuara në Ligjin e ri të Pronësisë, Gjykata vëren se pala shqiptare nuk kishte paraqitur ndonjë fakt për të provuar efektivitetin e këtyre mjeteve. Autoritetet shqiptare nuk provuan se ligji i ri mund të kishte ofruar në të vërtetë ndreqje për ankuesit dhe se shteti mund të kishte plotësuar efektivisht detyrimin e tij për të paguar kompensim për pronën fillestare, konform vendimit të formës së prerë në favor të ankuesve.

56. Në këtë mënyrë, Gjykata hedh poshtë kundërshtimet e palës shqiptare në lidhje me neglizhencën e ankuesve për të përdorur mjetet e brendshme juridike.

57. Gjykata çmon se kjo pjesë e ankimit nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35§ 3 të Konventës. Më tej vëren se kjo pjesë nuk është e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Kështu, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Themeli

58. Pala shqiptare përsëriti se autoritetet nuk mund të deklaroheshin përgjegjëse për mosekzekutimin e vendimit të dhënë në favor të ankuesve, pasi ekzekutimi i tij varej nga marrja e hapave të nevojshme prej ankuesve, konkretisht duke ngritur një padi që kërkonte ekzekutimin e vendimit. Pala shqiptare iu referua argumenteve të veta të mëparshme mbi përdorimin e mjeteve të brendshme juridike.

59. Ankuesit e kundërshtuan këtë argument.

60. Gjykata përsëriti jurisprudencën e saj në kuptimin që e drejta e aksesit në gjykatë, e garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës, do të ishte joreale, nëse sistemi i brendshëm ligjor i një Shteti Palë do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej jooperativ, në dëm të njërës palë. Ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e "procesit të rregullt" për qëllime të nenit 6 (shih, midis të tjerash, Hornsby v. Greece, vendimi i datës 19 mars 1997, Reports 1997-II, fq 510-11, §§40 et seq dhe Metaxas, cituar më sipër, §25).

61. Gjykata çmon se problemet e përfshira në çështjen e ankuesve janë pjesë e procesit të kalimit nga sistemi i shkuar ligjor komunist dhe regjimi i tij i pronësisë në një rend të pajtueshëm me shtetin ligjor dhe ekonominë e tregut. Ky proces, në vetë natyrën e gjërave, është shoqëruar me vështirësi. Gjykata ka parashtruar në këtë aspekt se Konventa nuk mund të interpretohet si vendosje e detyrimit të përgjithshëm mbi Shtetet Kontraktuese për të kthyer pronën e transferuar në favorin e tyre, para ratifikimit të Konventës (shih Kopecky v. Slovakia [GC], No 44912/98, § 35 dhe von Maltzan and Others v. Germany (dec.) [GC], No 71916/01, 71917/01 dhe 10260/02, § 74, ECHR 2005-V). Nuk ekziston ndonjë detyrim i përgjithshëm, sipas Konventës për krijimin e procedurave nëpërmjet të cilave mund të kërkohet kthimi i pronave. Megjithatë, kur një Shtet Kontraktues vendos të krijojë procedura ligjore të këtij lloji, ai nuk mund

të përjashtohet nga detyrimi për të respektuar të gjitha garancitë përkatëse të parashikuara nga Konventa, veçanërisht në nenin 6 § 1.

62. Gjykata vëren se legjislacioni shqiptar i kohës në fjalë la në diskrecionin e autoriteteve administrative përcaktimin e formës së përshtatshme të kompensimit, për ato raste kur kthimi në natyrë i pronës ishte i pamundur. Kështu, vendimi i Gjykatës së Apelit në rastin konkret, mund të interpretohet si urdhërim i autoriteteve për t'u ofruar ankuesve një formë kompensimi që do t'i zhdëmtonte ata në vend të kthimit të të drejtave të tyre të pronësisë.

63. Gjykata nuk e pranon pikëpamjen e palës shqiptare sa i takon mungesës së interesit nga ana e ankuesve për ekzekutimin e vendimit. Në fakt, ankuesit nuk e pranuan rezultatin e procedimeve, që shpunë në vendimin e datës 11 prill 2001 dhe kërkuan kthimin në natyrë të pronës në vend të kompensimit.

64. Referuar fakteve të çështjes, Gjykata vëren se pas shpalljes së vendimit në vitin 2001, autoritetet neglizhuan t'u ofronin ankuesve ndonjë opsion të përshtatshëm për kompensim, në pajtim me vendimin e formës së prerë të gjykatës (shih, duke bërë krahasimin, Uzkureliene and Others v. Lithuania, nr. 62988/00, § 36, të datës 7 prill 2005). Kështu, ankuesit nuk patën asnjë mundësi të shqyrtonin një ofertë kompensimi, në proporcion me kthimin në natyrë të pronës.

65. Për më tepër, Gjykata çmon se pala shqiptare nuk dha ndonjë shpjegim se pse vendimi i datës 11 prill 2001 në favor të ankuesve nuk ishte ekzekutuar për më shumë se pesë vjet pas shpalljes. Nuk ka të dhëna se përmbaruesit ose autoritetet administrative të kenë marrë ndonjë masë për t'iu bindur vendimit.

66. Konsideratat e mësipërme janë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Gjykatës të konstatojë, se duke neglizhuar të marrin masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin e datës 11 prill 2001, autoritetet shqiptare i zhveshën dispozitat e nenit 6§1 të Konventës nga të gjitha efektet e dobishme.

67. Pra, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

68. Gjykata analizoi më sipër pretendimin e ankuesve rreth neglizhencës së autoriteteve për të zbatuar vendimin e formës së prerë, që u njohu atyre një formë kompensimi. Ajo vëren se pretendimi i ankuesve sipas nenit 13, është kryesisht i bazuar në të njëjtën mungesë mbrojtjeje procedurale, e cila u çmua se u bë shkak për shkelje të nenit 6 (shih, mutadis mutandis, British-American Tobacco Company Ltd v. the Netherlands, vendimi i datës 20 nëntor 1995, Seria A, nr. 331, fq 29, § 91). Në këto rrethana, Gjykata çmon se nuk është e nevojshme të shqyrtojë ankesën ndarazi, sipas nenit 13.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 E PROTOKOLLIT NR 1, E MARRË INDIVIDUALISHT DHE NË LIDHJE ME NENIN 14 TË KONVENTËS

69. Ankuesit pretenduan, se u është cenuar e drejta për të gëzuar pronën e trashëguar nga i ati. Ata u mbështetën në nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, i cili parashikon:

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t'i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të nxjerrë ligje, që ato i gjykojnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave".

70. Duke cituar nenin 14 të Konventës, ankuesit deklaruan se të drejtat e tyre në kuadrin e procesit të kthimit ishin cenuar për shkak të statusit të tyre shoqëror. Neni 14 vijon si më poshtë:

"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër."

A. Pranueshmëria

1.Parashtrimet e palëve

71. Pala shqiptare kundërshtoi pretendimet e ankuesve, sipas këtij kreu. Autoritetet

argumentuan se meqë vendimi i Komisionit që u kthente ankuesve pasurinë e të atit të tyre ishte përmbysur nga vendimet e gjykatave, ankuesit nuk mund të pretendonin të drejta pronësie mbi vilën. Në këtë mënyrë, duke marrë parasysh vendimin e gjykatës, që kishte vendosur mbi pretendimet e tyre të pronësisë, ankuesit kishin të drejtë të përfitonin prej garancive të ofruara nga neni 1 i protokollit nr. 1, vetëm në lidhje me parcelat e tokës me sipërfaqe përkatësisht 48.55 metra katrorë dhe 46.70 metra katrorë.

72. Në përputhje me dispozitat e legjislacionit të brendshëm, duke qenë e pamundur që atyre t'u kthehej prona fillestare, gjykata kishte mbështetur të drejtat e paditësve për kompensim në një nga format e parashikuara nga neni 16 i Ligjit të Pronave të vitit 1993.

73. Ata parashtruan që ashtu si shumë ish-pronarë në Shqipëri, të cilët kishin vendime detyruese gjykate që vendosnin për çështjen e kompensimit, as ankuesit nuk mund të fajësonin shtetin për shkak të pasivitetit që ata vetë kishin dëshmuar për të filluar procedurat e ekzekutimit, qoftë në gjykatat shqiptare, qoftë me anë të mjeteve të reja juridike të parashikuara nga Ligji i Pronave i vitit 2004, me qëllim kthimin e pronave të tyre dhe kërkimin e dëmshpërblimit.

74. Ankuesit kundërshtuan parashtrimet e autoriteteve shtetërore.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Përmbledhje e parimeve përkatëse

75. Gjykata përsëriti parimet e mëposhtme të përcaktuara në jurisprudencën e saj sa i takon nenit 1 të protokollit nr. 1 (shih von Maltzan etj., cituar më sipër dhe Kopecky, cituar më sipër, §35).

76. a) Privimi nga e drejta e pronësisë ose nga një e drejtë tjetër *in rem* është në parim një veprim i përkohshëm dhe nuk krijon një situatë të vazhdueshme të "privimit nga një e drejtë" (shih Malhous v. the Czech Republic (dec) [GC], No 33071/96, ECHR 2000-XII, me referenca të mëtejshme).

77. b) Neni 1 i protokollit nr.1 nuk garanton të drejtën për të fituar pasuri (shih Van der Mussele v. Belgium, vendimi i datës 23 nëntor 1983, Seria A nr. 70, fq 23, § 48 dhe Slivenko and Others v. Letonia (dec) [GC], No 48321/99, §121, ECHR 2002-II).

78. c) Një ankues mund të pretendojë një shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1, vetëm për sa kohë që vendimet e kundërshtuara kanë pasur lidhje me "pasuritë" e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite. "Pasuritë" mund të jenë "pasuri ekzistuese" ose asete, përfshirë pretendime në lidhje me të cilat ankuesi mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një "pritshmëri të ligjshme" për të fituar gëzim efektiv të një të drejte për pronën. Duke bërë krahasime, shpresa për njohjen e një të drejte pronësie, e cila ka qenë e pamundur të ushtrohej efektivisht, nuk mund të konsiderohet si "pasuri" brenda kuptimit të nenit 1 të protokollit nr. 1, madje as një pretendim i kushtëzuar që vjen si rezultat i mosplotësimit të kushtit (shih Prince Hans-Adam II of Liechtenstein v. Germany [GC], nr. 42527/98, § § 82 dhe 83, ECHR 2001-VIII dhe Gratzinger and Gratzingerova v. the Czech Republic (dec) [GC], nr. 39794/98, § 69, ECHR 2002-VII).

79. d) Kur interesi i pronarit ka natyrën e një ankimi, ai mund të konsiderohet si "aset", vetëm nëse referuar legjislacionit vendas, ky ankim është mjaftueshmërisht i bazuar, p.sh., kur ekziston një praktikë e konsoliduar e gjykatave vendase në mbështetje të tij, ose kur ai (ankimi) mer formën e një vendimi përfundimtar, të ekzekutueshëm në favorin e ankuesit [shih Draon v. France [GC], No 1513/03, § 68, i datës 6 tetor 2005 dhe Burdov v. Russia, No 59498/00, § 40, ECHR 2002-III).

80. e) Neni 1 i protokollit nr. 1 nuk mund të interpretohet sikur vendos ndonjë detyrim të përgjithshëm mbi Shtetet Kontraktuese për të kthyer pasuritë e transferuara në favor të tyre, para se të ratifikonin Konventën. Neni 1 i protokollit nr. 1 nuk vendos kufizime as mbi lirinë e Shteteve Kontraktuese për të përcaktuar objektin e kthimit të pronës dhe për të përzgjedhur se në çfarë kushtesh bien dakord t'u kthejnë të drejtat e pronës ish-pronarëve (shih Jantner v. Slovakia, No 39050/97, § 34, 4 mars 2003).

81. Në veçanti, Shtetet Kontraktuese gëzojnë një shkallë të gjerë vlerësimi sa i takon përjashtimit të kategorive të caktuara të ish-pronarëve nga kjo e drejtë. Kur kategoritë e pronarëve përjashtohen në këtë mënyrë, pretendimet e tyre për kthim nuk mund të shërbejnë si bazë për "pritshmëri të ligjshme", që kërkon mbrojtjen e nenit 1 të protokollit nr. 1 (shih, midis

autoriteteve të tjera, Gratzinger and Gratzingerova, cituar më sipër, § § 70-74).

82. Nga ana tjetër, kur një Shtet Kontraktues që ka ratifikuar Konventën, përfshirë Protokollin e Parë Shtesë, dekreton legjislacionin që rregullon kthimin e plotë ose të pjesshëm të pronës së konfiskuar në regjimin e mëparshëm, ky legjislacion mund të konsiderohet si gjenerues i një të drejte të re pronësie, të mbrojtur nga neni 1 i protokollit nr. 1 për personat që i plotësojnë kushtet për të fituar një të drejtë të tillë. E njëjta gjë mund të aplikohet në lidhje me rregullimet ligjore për kthimin ose kompensimin të parashikuara para ratifikimit, nëse ky legjislacion mbetet në fuqi, pas ratifikimit nga Shteti Kontraktues i Protokollit të Parë Shtesë (shih Broniowski v. Poland [GC], 31443/96, §125, ECHR 2004-V).

b) Zbatimi i parimeve përkatëse

83. Gjykata vëren se sipas këtij kreu, ankuesit shfaqën pakënaqësi për dy çështje të ndryshme. Së pari, ata u ankuan për një shkelje të të drejtave të tyre të pronësisë mbi vilën. Së dyti, ata u ankuan për një shkelje të të drejtave të tyre të pronësisë, për sa kohë që autoritetet nuk kishin arritur të ekzekutonin vendimin e gjykatës të datës 11 prill 2001. Gjykata do të shqyrtojë ndarazi secilën prej këtyre ankesave.

i) Pretendimet e pronësisë mbi vilën

84. Për sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë në lidhje me vilën, Gjykata ripohon se e drejta e kthimit nuk garantohet as në Konventë, as në jurisprudencën e saj.

85. Meqë vila në fjalë u shpronësua në vitin 1978, është e qartë se nuk mund të thuhet, që ankuesit kanë "pasuri ekzistuese" brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë.

86. Kështu, mbetet për t'u shqyrtuar nëse ankuesit mund të kenë ndonjë "pritshmëri të ligjshme" për realizimin e pretendimit të tyre, ndaj kthimit, mbi bazën e parashikimeve të Ligjit të Pronave.

87. Gjykata vëren se në procedimet e ankimuara u ngrit problemi nëse detyrimet që rridhnin nga Ligji i Pronës ishin plotësuar apo jo. Autoritetet gjyqësore konstatuan se kjo çështje nuk lidhej me pretendimet e kërkuesve mbi vilën.

88. Pra, pakënaqësia e ankuesve në themel konsiston në kundërshtimin e konkluzioneve të gjykatave vendase dhe në gabimet që pretendohet se këto autoritete kanë bërë në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit vendas.

89. Gjykata vëren në këtë aspekt se fakti që shteti, nëpërmjet sistemit të tij gjyqësor, siguroi një forum për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të ankuesve, automatikisht nuk e bën atë përgjegjës në kuptimin e nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë. Në rastin konkret, shteti nuk është përgjegjës për humbje të shkaktuara si rezultat i vendimeve të gjykatave, që cenuan në mënyrë arbitrare apo joproporcionale pronën. Duke pasur parasysh konkluzionet e saj të mësipërme, sipas nenit 6 §1 të Konventës (në lidhje me gjykimin e drejtë) se gjykatat kombëtare proceduan në përputhje me legjislacionin e brendshëm, duke shqyrtuar çështjen e ankuesve në detaje dhe duke dhënë arsye të plota për vendimet e tyre, Gjykata konstaton se vlerësimi i kryer nga gjykatat kombëtare nuk mund të konsiderohet haptazi arbitrar ose i paarsyeshëm.

90. Gjykata çmon se në këtë mënyrë ankuesit nuk mund të kishin "pritshmëri të ligjshme", bazuar qoftë në dispozitat e Ligjit të Pronave apo vendimin e Komisionit të vitit 1996 që njihte të drejtën e tyre ndaj vilës, për të realizuar pretendimin e tyre për kthimin e vilës. Për pasojë, kjo pjesë e ankimit nuk është e pajtueshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës brenda kuptimit të nenit 35 § 3 dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§4.

91. Duke marrë në konsideratë faktin që neni 14 i Konventës nuk është i pavarur dhe konkluzionin që neni 1 i Protokollit të Parë Shtesë nuk është i zbatueshëm sipas këtij kreu, Gjykata çmon se neni 14 nuk mund të zbatohet në lidhje me këtë ankim (shih mutadis mutandis, Polacek and Polackova v. the Czech Republic (dec) {GC}, No 38645/97, §§61-70, 10 korrik 2002).

92. Për pasojë, ky ankim duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 § § 3 dhe 4 të Konventës.

ii) Pretendimet e pronësisë mbi parcelat e tokës

93. Gjykata vëren se ankimi sipas këtij kreu nuk është haptazi i pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër, ajo vëren se nuk ka gjetur ndonjë arsye për të

deklaruar këtë pjesë të ankimit si të papranueshme dhe kështu e deklaron atë të pranueshme.

94. Për sa i përket pretendimit të ankuesve që të drejtat e pronësisë së tyre mbi parcelat e tokës janë shkelur për shkak të statusit të tyre shoqëror në kundërshtim me nenin 14, Gjykata nuk konstaton asnjë shenjë se ankuesit kanë qenë të diskriminuar për arsye të specifikuara në nenin 14 të Konventës. Kështu, pretendimi i tyre, sipas nenit 14 të Konventës marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit të Parë Shtesë (për sa i përket pretendimeve të tyre mbi parcelat e tokës) është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në pajtim me nenin 35 § § 3 dhe 4 të Konventës.

B. Themeli

95. Pala shqiptare deklaroi se nuk mbante përgjegjësi për faktin që ankuesit nuk ishin të kënaqur me rezultatin e procedimeve gjyqësore sa u takon pretendimeve për pronën e të atit të tyre në përgjithësi dhe pretendimit të tyre për kthimin në natyrë të pronës në veçanti.

96. Pala shqiptare shtoi se pamundësia për të ekzekutuar vendimet e formës së prerë që jepnin kompensim në kuadër të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave ishte për shkak të rrethanave objektive, si mungesa e fondeve dhe ndikimi i tyre mbi interesin e përgjithshëm të komunitetit.

97. Ankuesit pretenduan se deklaratat e palës shqiptare ishin të pabazuara. Ata parashtruan se shteti ishte përgjegjës për borxhet e papaguara ndaj tyre, të tilla si kompensimi dhe se duke mos arritur të paguante ato borxhe për një kohë të gjatë, shteti i kishte privuar ata nga e drejta për të poseduar realisht pronën, në shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1.

98. Gjykata vëren se ky ankim është i lidhur me atë të shqyrtuar sipas nenit 6 § 1, në lidhje me pamundësinë për të ekzekutuar një vendim të formës së prerë.

99. Gjykata pohon se “pasuritë” mund të jenë “pasuri ekzistuese” ose asete, përfshirë për disa raste të përcaktuara qartë edhe pretendimet. Që një pretendim të konsiderohet “aset” brenda qëllimit të nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë, pretenduesi duhet të provojë që në legjislacionin vendas ekziston një bazë e mjaftueshme, p.sh. që ka një praktikë gjyqësore vendase të konsoliduar në mbështetje të pretendimit të tij, ose që ekziston një vendim gjykate i formës së prerë në favor të pretenduesit. Kur kjo arrihet, mund të hyjë në veprim koncepti i “pritshmërisë së ligjshme” (shih Draon, cituar më sipër, § 65 dhe Burdov, cituar më sipër).

100. Në rastin konkret, është konstatuar tashmë se autoritetet kishin një detyrim sipas vendimit të datës 11 prill 2001 për t’u ofruar ankuesve një formë kompensimi në vend të kthimit në natyrë të dy parcelave të tokës. Për pasojë, ankuesit kishin pretendime të zbatueshme që buronin nga vendimi në fjalë.

101. Gjykata çmon se neglizhenca e autoriteteve për të ekzekutuar vendimin në favor të ankuesve konsiderohet cenim i të drejtës së tyre për gëzimin paqësor të pasurive të tyre në kuptimin e nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

102. Duke mos iu bindur vendimit të Gjykatës së Apelit të Tiranës, autoritetet vendase i lanë ankuesit në një gjendje pasigurie për sa u përket shanseve për të rifituar të drejtat e tyre të pronësisë. Për më tepër, për një periudhë të konsiderueshme kohore, autoritetet i privuan ankuesit nga e drejta për t’iu paguar vlera e kompensimit dhe nga gëzimi i zotërimit të parave të tyre. Për sa i përket justifikimit të parashtruar nga pala shqiptare për këtë ndërhyrje, Gjykata rikujton se mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë një neglizhencë nga ana e shtetit për të ekzekutuar një vendim detyrues të formës së prerë për shlyerje borxhi (shih Pasteli and Others v. Moldova, nr. 9898/02, 6255/02 dhe 10425/02, § 30, 15 qershor 2004, Voytenko v. Ukraine, No 18966/02, § 55, 29 qershor 2004; Shmalko v. Ukrainë, nr. 60750/00, § 57, 20 korrik 2004).

103. Për pasojë, ka pasur një shkelje të nenit 1 të Protokollit të Parë Shtesë të Konventës lidhur me çështjen e kompensimit.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

104. Neni 41 i Konventës parashikon:

Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqjen e pjesshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.

A. Dëmi

105. Ankuesit pretenduan 564 000 euro në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror. Ata u mbështetën në një raport vlerësimi ekspertësh, për qëllime të përcaktimit të vlerës së përgjithshme të pasurive të të atit të tyre dhe humbjen e përfitimeve.

106. Pala shqiptare kundërshtoi pretendimet e ankuesve, meqë në pikëpamjen e saj, kërkesa ishte e papranueshme. Ata nuk paraqitën asnjë argument në lidhje me shumat e pretenduara për dëmin pasuror dhe jopasuror.

107. Gjykata çmon se pretendimi i ankuesve për dëm në lidhje me prona të ndryshme nga ato që u caktohen atyre nga gjykatat lokale, janë *ultra petita* dhe për pasojë, e kundërshton këtë pretendim.

108. Gjykata u referohet konkluzioneve të saj në çështjen *Qufaj k Shqipërisë*, ku parashtroi se autoritetet shqiptare duhet të merrnin masat e përshtatshme, me qëllim pajtimin me vendimin e formës së prerë dhe të bënin kompensim për ndonjë dëm të shkuar ose të ardhshëm shkaktuar individëve nga neglizhenca. Për më tej, ajo çmoi se në ekzekutim të vendimeve sipas të cilave shteti ishte urdhëruar të kryente një pagesë, një personi i cili disponon një vendim gjyqësor për shlyerje borxhi nga ana e shtetit në favorin e tij, nuk duhet t'i kërkohet të fillojë procesin e ekzekutimit për të përfituar kompensimin (shih Qufaj Co sh.p.k. v. Albania, nr. 54268/00, § 54-59, 18 nëntor 2004 dhe gjithashtu Metaxas, cituar më sipër, § 49).

109. Gjykata vlerëson se nuk ka arsye për të devijuar nga konkluzioni i saj i mësipërm sa u takon vendimeve përfundimtare, që urdhërojnë kthimin dhe/ose kompensimin e pronave.

110. Gjykata pohon se një vendim nëpërmjet të cilit ajo konkludon se ka pasur shkelje, vendos shtetin e paditur para detyrimit ligjor sipas Konventës për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të riparuar pasojat e saj. Nëse legjislacioni i brendshëm mundëson vetëm riparim të pjeshëm të dëmit, neni 41 i Konventës i jep Gjykatës kompetencë për të kompensuar palën e dëmtuar për veprimin apo mosveprimin që çoi, u bë shkak për të konstatuar shkelje. Gjykata gëzon një lloj diskrecioni në ushtrimin e kësaj kompetence, siç provohet edhe nga mbiemri "i drejtë" dhe fraza "nëse është e nevojshme".

111. Midis çështjeve që Gjykata merr parasysh kur vlerësohet kompensimi, janë dëmi pasuror, domethënë, humbja aktualisht e shkaktuar si rezultat i drejtpërdrejtë i shkeljes së pretenduar dhe dëmi jopasuror, domethënë kompensimi për ankthin, vështirësitë dhe pasigurinë e shkaktuar nga shkelja dhe dëme të tjera jopasurore (shih, midis autoriteteve të tjera, Ernestina Zullo v. Italy, nr. 64897/01, § 25, 10 nëntor 2004).

112. Për më tepër, nëse një ose më shumë kategori specifike të dëmit nuk mund të llogariten saktësisht ose nëse dallimi midis dëmit pasuror dhe jopasuror duket i vështirë, Gjykata mund të vendosë të bëjë një vlerësim global (shih Comingersoll v. Portugal [GC], No 35382/97, § 29, ECHR 2000-IV).

113. Në rrethanat e çështjes, gjykata çmon se duke mos pasur mundësi për të marrë masa të përshtatshme për t'u dhënë ankuesve kompensim për pamundësinë për t'u kthyer pronën fillestare në lidhje me dëmin pasuror, shteti duhet t'u paguajë ankuesve një shumë që i korrespondon vlerës aktuale të pronës përkatëse- domethënë, parcelat e tokës që maten përkatësisht me 48.55 metra katrorë dhe 46.70 metra katrorë.

114. Për më tepër, Gjykata çmon se çështjet në fjalë përfshijnë një ndërhyrje serioze në të drejtën e ankuesve për gëzimin paqësor të zotërimeve të tyre, në lidhje me të cilin një shumë parash do të përfaqësonte një kompensim të drejtë për dëmin jopasuror të pësuar.

115. Duke e kryer vlerësimin e saj mbi baza të barabarta, siç kërkohet nga neni 41 i Konventës, Gjykata u jep ankuesve një shumë totale prej 120 000 eurosh në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror.

Kostot dhe shpenzimet

116. Ankuesit gjithashtu pretenduan 36 000 euro për kostot dhe shpenzimet para gjykatave kombëtare dhe para Gjykatës. Ata nuk dhanë analizë të detajuar për vërtetimin e kostove dhe shpenzimeve të pretendimit të tyre.

117. Pala shqiptare e kundërshtoi pretendimin.

118. Referuar praktikës së Gjykatës, një ankues autorizohet për rimbursimin e kostove dhe shpenzimeve të tij, vetëm për sa kohë që provohet se këto janë shkaktuar në të vërtetë dhe pashmangshmërisht kanë qenë të arsyeshme për sa i përket sasisë.

119. Kostot e pretenduara nuk kanë qenë të bazuara, pasi ankuesit nuk kanë paraqitur detaje në zëra të të gjitha shpenzimeve gjyqësore, postën, telefonatat dhe fotokopjen e dokumenteve.

120. Duke pasur parasysh informacionin që disponon dhe kriteret e përcaktuara më sipër, Gjykata çmon të arsyeshme të japë shumën prej 6000 euro, që mbulon kostot sipas të gjitha kategorive specifike.

Interesi i mospagimit

121. Gjykata çmon të nevojshme që interesi i mospagimit duhet të bazohet në normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane, së cilës duhet t'i shtohen tre pikë për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT

1. Hedh poshtë kundërshtimet paraprake të palës shqiptare;

2. I deklaron ankesat në lidhje me nenin 6 § 1 (për sa i përket moszbatimit të një vendimi të formës së prerë), nenin 13 dhe nenin 1 të protokollit nr. 1 të pranueshme dhe pjesën e mbetur të kërkesës, të papranueshme;

3. Vlerëson se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës;

4. Vlerëson se nuk është nevoja të shqyrtohet ankimi sipas nenit 13 të Konventës;

5. Vlerëson se ka pasur një shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës;

6. Vlerëson se:

Shteti i paditur duhet t'u paguajë ankuesve, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, sasitë e mëposhtme që duhen konvertuar në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, plus ndonjë taksë që mund jetë e tatueshme:

- 120 000 euro (njëqind e njëzet mijë euro) në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror;
- 6000 euro (gjashtë mijë euro) në lidhje me kostot dhe shpenzimet;
- që nga skadimi i afatit të mësipërm tremujor deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë për qind;

7. Hedh poshtë pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesve për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 22 gusht 2006, sipas nenit 77 § § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

T.L. Early
Regjistrues

Nikolas BRATZA
President